

V E N D I M
Nr.560, datë 21.11.1994

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.138,DATË
31.3.1994 “PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE”.**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994 pas kreut I shtohet kreu I/A me këtë përmbajtje:

“I/A. Kompensimi i dytë (shtesë) i shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse, duke filluar nga data 1 dhjetor 1994:

1) Në masën 150 lekë në muaj:

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror buxhetor që kanë pagën bazë sipas klasës deri në 6700 lekë në muaj (pa shtesat e ndryshme mbi pagën bazë).

b) Personat që përmenden në kreun I, pika 2, shkronjat b,c, dhe pika 4 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994.

c) ushtarakët që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur shpërblimi që përfitojnë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.225, datë 29.5.1992, është deri në 6700 lekë në muaj. Kur këta persona punojnë si civilë pranë personave juridikë a fizikë, vendas ose të huaj, dhe paga së bashku me shpërblimin si ushtarak është mbi 6700 lekë në muaj, nuk e përfitojnë këtë kompensim.

2) Në masën 300 lekë në muaj:

Familjet, të cilat kanë vetëm një person që përfiton kompensim sipas pikës 1, shkronjat a,b dhe c të këtij vendimi.

3) Efektet financiare prej 124 milione lekë për periudhën 1 dhjetor deri në 31 dhjetor 1994 përballohen brenda buxhetit të shtetit për vitin 1994. Ministria e Financave të bëjë detajimin e fondeve për çdo ministri dhe institucion qendror dhe për organet e pushtetit lokal.

4) Rekomandohet për t’u zbatuar ky vendim edhe për të punësuarit në sektorin shtetëror jobuxhetor, në sektorin privat, në shoqëritë e përbashkëta, banka, INSIG-u, organizatat politike, shoqërore e në shoqata brenda mundësive financiare që ato kanë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi